



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

RAPORT I AKTIVITETIT TË
QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË
PËR PERIUDHËN KOHORE
JANAR- DHJETOR 2021

Miratoi

Eduart MAKRI

KRYETAR

Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit dhe misionit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK)

QKK është institucion qendror, që ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë” të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të zbatim të tij. Misioni kryesor i QKK është mbështetja financiare dhe promovimi i prodhimit kinematografik në Shqipëri.

QKK, që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentar dhe të animuar, si dhe projekteve të ndryshme kinematografike dhe festivalet e filmit. Nëpërmjet financimeve prioritet i jepet projekteve që garantojnë bashkëprodhim, kryesisht atyre ndërkombëtar. Kjo është një strategji efikase për të siguruar distribucion dhe audiencë për filmat edhe jashtë vendit.

QKK është përfaqësuese e Shqipërisë pranë strukturave ndërkombëtare kinematografike EURIMAGES, SEE, European Film Promotion, Creative Europe.

Për arsye të buxhetit të pamjaftueshëm, kushtëzuar edhe nga kontratat e lidhura gjatë vitit 2020, këtë vit nuk u hapën disa konkurse si për film të shkurtër, film dokumentar, minority co-production, etj.

Në vitin 2021 pas procesit të vlerësimit fitojnë të drejtën për financim 18 projekte.

Më konkretisht :

- 2 Filma artistikë me metrazh të gjatë;
- 2 Filma artistikë me metrazh të gjatë, vepër e parë;
- 6 Filma artistikë me metrazh të shkurtër (temë diplome të studentëve të UA);
- 3 Projekte të ndryshme kinematografike;
- 5 Festivale Ndërkombëtare Filmi.

1. Filma të përfunduar gjatë vitit dhe që kanë realizuar premierat:

Janë përfunduar dhe kanë realizuar premierat për publikun 16 projekte filmike, si më poshtë:

1.1. Filma artistikë metrazh të gjatë:

- **Filmi “2 luanë drejt Venecias”** - skenari dhe regjia Jonid Jorgji
- **Filmi “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”** – skenari (adaptuar nga romani me të njëjtin titull i Dritëro Agollit) dhe regjia Fatmir Koci.
- **Filmi “Xixëllonjat”** - skenari dhe regjia Artur Gorishti.
- **Filmi “Legjenda e bastunit”** – skenari dhe regjia Xhoslin Rama.

1.2. Filma minority coproduction:

- **Filmi “Zgjoji,”** - regjia Blerta Basholli- premierë botërore në Sundance International Film Festival, USA
- **Filmi “Virgjëresha Shqiptare,”** - regjia Bujar Alimani - premierë botërore në Varshavë International Film Festival, Poloni
- **Filmi “Kopeja e deleve,”** - regjia Dimitris Kanellopoulos- premierë botërore në Thesaloniki International Film Festival, Greqi
- **Filmi “Vera andrron detin,”** – regjia Kaltrina Krasniqi - premierë botërore në Venecia International Film Festival, Itali

1.3. Filma artistikë me metrazh të shkurtër:

- **Filmi “Mbjellja e pemëve,”**- skenari Ylljet Alicka dhe regjia Fabio Seferi.
- **Filmi “Kadillak dhe manaferra,”** – skenari Bujar Alimani dhe regjia Suela Bako.
- **Filmi “Sheets,”** - skenari Genc Përmeti dhe regjia Evi Gjoni.
- **6 filma të shkurtër** të diplomimit të studenteve të vitit akademik 2020-2021 të Universitetit të Arteve (financuar në kuadër të marrëveshjes Pakti për Universitetin midis Ministrisë së Kulturës, Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Universitetit të Arteve).

1.4. Filma dokumentarë:

- **Filmi “Bijtë e Kainit,”** - skenari dhe regjia Ketii Stamo - premierë botërore në Venecia International Film Festival, Itali në seksionin Ditët e Autorëve në Netët Veneciane.

1.5. Filma të animuar:

- **Filmi “Legjenda e vendit t'shenjt”** - skenari dhe regjia Eliona Thomaraj

2. Festivale ndërkombëtare brenda vendit gjatë vitit 2021:

- KO:SH Film Festival, Korrik.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit dhe Kulinarisë, Pogradec, Shtator.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit "TIFF", Tirane, Shtator.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut, Shtator.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit "A-Film Fest", Tetor Gjirokastrë dhe Gusht Shkodër

3. Projekte të ndryshme për vitin 2021:

3.1. Projekti "Balkan Film Market", Otranto, Tiranë.

3.2. Projekti "Open Cinema-V" Maj – Shtator 2021.

3.3. Projekti "Cinema&City" – Korrik – Dhjetor 2021.

4 Përfaqësim në festivale filmi dhe aktivitete të tjera të rëndësishme ndërkombëtare:

- Pjesëmarrje e Kryetarit të QKK si dhe stafit të filmit "Virgjëresha Shqiptare" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Varshavë për premierën e filmit.
- Pjesëmarrje e Kryetarit të QKK në Balkan Film Festival zhvilluar në Romë.
- Pjesëmarrje e Kryetarit të QKK në Agora Film Market zhvilluar në Selanik.

5. Aktivitete ndërkombëtare jashtë vendit 2021:

- Java e Filmit shqiptar në Shkup, Tetor 2021.

6. FONDE ALTERNATIVE TË SIGURUARA GJATË VITIT 2021

6.1. Përfundoi projekti "Digjitalizimi i plotë i sallave të kinemave në qytetin e Gjirokastrës dhe Vlorës". Këto kinema u vunë në funksionim nëpërmjet mbështetjes financiare të programit Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme "Italy-Albania-Montenegro".

6.2. Janë financuar nga Eurimages 2 projekte filmike të metrazhit të gjatë

- **Projekti për film artistik me metrazh të gjatë “Misioni”,** skenari dhe regjia Andi Deliana.
- **Projekti për film artistik me metrazh të gjatë - vepër e parë “Burri i shtëpisë”,** skenari dhe regjia Andamion Murataj.

6.3. Janë financuar nga SEE Cinema Network 2 projekte filmike:

- **Projekti për zhvillim për film artistik me metrazh të gjatë “Sexcut”,** skenari dhe regjia Eno Milkani.
- **Projekti për film artistik me metrazh të gjatë “The three of us”,** skenari dhe regjia Suela Bako.

7. Akte ligjore dhe projektakte:

7.1. Është miratuar **«Konventa e Këshillit të Evropës për Bashkëprodhimet Kinematografike»**. Konventa u miratua në Kuvend dhe më pas u dekretua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

7.2. Hartimi i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë” të ndryshuar”, si dhe relacioni përkatës.

Ky ka qenë një proces i gjatë, i shtrirë gjatë gjithë vitit, i cili ka marrë impenjimin e një pjese të stafit të QKK. Edhe përgatitja e RIA-s ka qenë një impenjim i madh.

Për përgatitjen e projektaktit janë bërë disa konsultime të grupit të punës të ngritur me urdhërin e Ministrit të Kulturës. Gjithashtu janë organizuar disa takime dakordësuese me përfaqësuesët e komunitetit të kineastëve si dhe kryetarët e shoqatave.

Përmbyllja e procesit të konsultimit me grupet e interesit u bë në takimin e datës 9.12.2021, ku mori pjesë edhe Ministri i Kulturës. Palët diskutuan dhe dhanë mendimet e tyre lidhur me projektaktin e përgatitur dhe të paraqitur për diskutim.

7.3. Ndryshimet e rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Gjithashtu, një iniciativë shumë e rëndësishme ka qenë edhe ndryshimet e bëra në Rregulloren e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, të cilat konsistojnë në marrjen e miratimit të shoqatave të kineastëve dhe

aplikimit për herë të parë të përfshirjes së gjithë komunitetit të kineastëve për përzgjedhjen e Këshillit të Miratimit të Projekteve. Ky proces tepër i rëndësishëm u parapri edhe nga procesi i regjistrimit të kineastëve. Kjo është një eksperiencë e parë e cila u testua vetëm me autorët dhe producentët e filmave artistikë me metrazh të gjatë.

Aplikimi për herë të parë i këtij procesi mund të quhet një arritje shumë e madhe për ecurinë e punës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Ky proces u realizua në mënyrë shumë transparente dhe korrekte dhe për të nuk pati asnjë kontestim apo ankimim.

8. Vlerësime në festivalet ndërkombëtare për filmat e mbështetur financiarisht nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë

8.1. Virgjëresha Shqiptare (Bashkëprodhim në minorancë)

- **Çmimin Special të Jurisë** në Varshavë International Film Festival
- **Çmimin Ekumenik** në Varshavë International Film Festival

8.2. Vera andrron detin (Bashkëprodhim në minorancë) fiton:

- **Inclusion Edipo Re Award** në Bienalen e Venecias
- **Female Authors under 40 Award** në Bienalen e Venecias
- **Best Film** në Tokyo International Film Festival

8.3. LOVE me regji të Dionis Papadhimitri: Best Feature Film

- **Best Director** në Northern Virginia International Film Festival
- **Best Screenplay** në Northern Virginia International Film Festival
- **Best Actor** (Genti Kame) në Northern Virginia International Film Festival
- **Best Supporting Actor** (Gentian Zenelaj) në Northern Virginia International Film Festival
- **Best Foreign Language Feature Film** në Northern Virginia International Film Festival
- **Special Jury Award** në edicionin e XVI të Cinema on the Bayou Film Festival, Louisiana USA.
- **Special Jury Award** në Bajou Film Festival, USA

8.4. Zgjoji (Bashkëprodhim në minorancë) me regji të Blerta Bashollit ka fituar:

- **Cmimin e Publikut** në kategorinë Ballkanike në Thessaloniki International Film Festival.

- **Filmi më i mirë në kategorinë «1-2 Competition»**, në Festivalin e Filmit në Varshavë.
- **Aktorja më e mirë** në Festivalin Seminci International Film Festival, Spanjë
- **Grand Jury Award** në Sundance International Film Festival, USA
- **Best Direction** në Sundance International Film Festival, USA
- **Audience Award** në Sundance International Film Festival, USA

8.5. Kopeja e deleve (Bashkëprodhim në minorancë) me regji të Dimitris Kanellopoulos ka fituar:

- **Çmimin e publikut FISCHER** në International Competition të edicionit të 62-të të festivalit të Selanikut

8.6. Open Door me skenar të Florenc Papas & Ajola Daja, regjia Florenc Papas

- Çmimi «UNISALENTO» në Festivalin e Filmit në Otranto, Itali.

8.7. Portreti i pambaruar i Clara Bellinit

- **Filmi më i mirë me metrazh të gjatë** në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Karlsruhe

8.8. Lajmi / The news, film artistik me metrazh të shkurtër regjia Lorin Terezi, financuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, është një nga filmat e nominuar në kategorinë Filmi më i Mirë i Shkurtër në European Film Awards 2021.

9. Filma të xhiruar gjatë vitit 2021:

9.1. Filma artistikë me metrazh të gjatë:

- Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo
- Legjenda e Bastunit (vepër e parë)
- I love you more (Minority Co-production)

9.2. Filma të shkurtër

- 2028: Reformation
- Mbjellja e pemëve
- Dori
- Pelikanët e zinj
- Tërmeti

- 6 filma të shkurtër të diplomimit të studenteve të vitit akademik 2020-2021 të Universitetit të Arteve

9.3. Film i animuar

- Burri

Film dokumentar

- Porto Palermo - ku mbijetoi populli i Dantes

10. Të dhëna për buxhetin e vitit 2021

Buxheti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë për vitin 2021, në total 138 milion lekë, prej të cilave:

- 108,250 milion lekë financime për projektet kinematografike;
- 1 milion lekë në zërin investime.

Të ardhurat dytësore janë realizuar 4,6 milion lekë, të cilat derdhen 100% në buxhetin e shtetit.